



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.748/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada - Gllogjani, Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës Naim Bytyqi nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet i bazuar apeli A.nr.748/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës Naim Bytyqi nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 1723C/07R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Komunën e Pejës, në Vendvotimin: 1723C/07R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimin, të vendosur si në pikën -II- të këtij dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.748/2021, të paraqitur nga Naim Bytyqi, Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës,, me të cilin

pretendon se Kryesuesi i Qendrës së Votimit 1723C/07R, Faik Mulaku nga Komuna e Pejës, me numër personal 1009006873, ka deklaruar se nga pakujdesia nuk janë transferuar votat e kandidatëve në radhët e AAK-së, nga numri 6, e deri në fund të listës së subjektit të lartcekur. Në vazhdim të apelit, kërkoi që të përmirësohet lista dhe të shpërndahet vota reale e cila është brenda kutive të votimit sepse këto vota mund ta ndryshojnë rezultatin e kandidatëve të cilët janë në garë për asamble brenda këtij subjekti politik. Lidhur me Qendrën e votimit të lartcekur kërkohet që të evidentohen votat me të cilat ai si kandidat është dëmtuar. Së bashku me apel ka bashkangjitur disa deklarata të familjarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, dhe provave të bashkangjitura në apel, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Naim Bytyqi, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 1723C/07R. Paneli, vlerëson se apeli i paraqitur nga Naim Bytyqi, me kërkesë që të rinumërohen votat për vendvotimin e lartcekur, është i bazuar ngase është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, e sidomos në deklaratën e Kryesuesit të Qendrës së Votimit, nga të cilat mund të konstatohet se për vendvotimin 1723C/07R, nuk janë bartur fletëvotimet e kandidatëve nga radhët e Subjektit Politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për kandidat për Kuvend Komunal nga numri 6 deri në fund të listës së këtij vendvotimi. Gjithashtu edhe nga deklaratat e Afrim Rizaj dhe Arber Pengjaj të dhëna si votues, të cilët kanë deklaruar se e kanë përkrahur dhe votuar kandidatin në lartcekur, mirëpo në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, rezulton se ankuesi nuk e ka asnjë votë në këtë vendvotim.

Andaj panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë të saktë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në

pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 748/2021 më datën 05.11.2021.

Kryesues i Panelit

Adnan Konishevc

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

